



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 18695 prot.

Pukë, më 02.04. 2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 06 Datë 02.04 2022

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. Ramiz Tafilaj

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të nenit 54, pika "m" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika "ç"; të ligjit nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 113, pika "dh", të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **Z. Ramiz Tafilaj** me motivacionin:

"Për kontributin e dhënë në demokratizimin e Shqipërisë, çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës. Për vlerësimin e punës së tij në nisma humanitare kudo në trojet shqiptare dhe angazhime për promovimin e vlerave kombëtare, kulturore, shkencore dhe edukative për brezat e rinj duke ngritur lart figuren dhe imazhin e Kombit Shqiptar".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, i ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Drejtore DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Ne mungese dhe me urdher

Zv.kryetari
Kristjan Marku

Jurist
Endrit Kraja

KRYETARI
Gjon Gjonaj



Adresa: Bashkia Pukë, sheshi "Gjergj Kastrioti (Skenderbeu)", e-mail: bashkiapuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiapuke.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Relacion

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI”

Z. Ramiz Tafilaj

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin **112/2013**, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, datë **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhëni e titullit qytetar nderi **z. Ramiz Tafilaj** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij, Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin, ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të vlerësohet figura e tij dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjojje publike për të gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në fushën e promovimit të vlerave të Shqipërisë në Amerikë. I lindur në Luminishtë të Deçanit, Kosovë, me 06.05.1949. Në 1974 vazhdoi arsimin e lartë në Houston. Filloi karrieren si programues kompjuteri ku dhe u bë sipërmarrës i suksesshëm në industrinë e teknologjisë së lartë dhe atë petrokimike. Z. Tafilaj ka qenë vazhdimesh i angazhuar për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës dhe ka ndihmuar në vendosjen e demokracisë së Shqipërisë në vitet 1990, duke marrë pjesë në të gjitha demonstratat, bisedimet dhe takimet në Shqipëri (1989-1994). Ne 1994 sponsorizoi Ansamblin e Shtetit Shqipëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore në Amerikë dhe Kanada, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave artistiko-kulturore shqiptare. Temelues i shtypshkronjës “Jalifat”. Në fillim të vitit 2019 dekorohet me “Çmimi i Presidentit për Arritje Jetësore” nga Presidenti i SHBA-së Donald Trump. Në qershori të këtij viti dekorohet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, me njërin nga titujt më të lartë presidencial “Kalorësi i Urdhërit të Skendërbeut” për kontributin që jep në promovimin e vlerave kombëtare kudo në botë.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

T'i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë, **z. Ramiz Tafilaj** me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në demokratizimin e Shqipërisë dhe çlirimin e pavarësinë e Kosovës. Për vlerësimin e punës së tij në nisma humanitare kudo në trojet shqiptare dhe angazhime për promovimin e vlerave kombëtare, kulturore, shkencore dhe edukative për brezat e rinj duke ngritisur lart figuren dhe imazhin e Kombit Shqiptar”.

Ky titull i jepet në shenjë nderimi dhe vleresimi për të gjithë punën dhe kontributin e dhënë në fushën e promovimit të vlerave të Shqipërisë kudo në botë, **z. Ramiz Tafilaj**.

1. Për të gjitha meritat e lartpërmendura propozohet ti akordohet titulli “Qytetar Nderi i Bashkise Pukë”

Drejtor Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Emirjona Pergjegjaj

Adresa: Bashkia Pukë, sheshi “Gjergj Kastrioti (Skenderbeu)”, e-mail; bashkiapuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiapuke.gov.al

RAMIZ TAFILAJ

Ramiz Tafilaj (lindur më 6 maj 1949 në Luminishtë të Deçan, Republika e Kosovës) është një biznesmen, filantrop, aktivist dhe botues shqiptar me banim në Amerikë.

Ai ndoqi Universitetin e Zagrebit përpara se të emigronte në Shtetet e Bashkuara në vitin 1974 dhe vazhdoi arsimin e lartë në Houston. Pasi filloi karrierën e tij si programues kompjuteri, Tafilaj u bë një sipërmarrës i suksesshëm në industrinë e teknologjisë së lartë dhe atë petrokimiike. Ai themeloi Shërbimet Kompjuterike Superiore (eng: "Superior Computer Services") dhe Teknologjinë Kimike Progresive (eng: Progressive Chemical Technology), ku shërben si kryetar i bordit dhe zotëron gjithashtu kompaninë botuese "Jalifat".

Aktualisht, kryeson degën ndërkombëtare të kompanisë "CES Environmental Services Inc.". Është anëtar i rëndësishëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ndërsa në Teksas është pjesëtar i Partisë Republikane.

Tafilaj shërbeu si President i Divisionit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë Veriperëndimore, ku promovoi bizneset e Teksasit në nivel ndërkombëtar, përmes delegacioneve në vende të Evropës dhe Azisë. Ai është Zëvendës President i Shoqatës Shqiptaro-Amerikane të Biznesit të Teksasit të Madh.

Z. Tafilaj ka qenë i angazhuar vazhdimisht për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës dhe ka ndihmuar përvendosjen e demokracisë në Shqipëri në vitet 1990, duke marrë pjesë në të gjitha demonstratat, bisedimet dhe takimet në Shqipëri (1989-1994).

Një aktivist në lobimin shqiptar në Amerikë, për të dërguar zërin e duhur në institucionet Amerikane për çështjet dhe çlirimin e Kosovës. Udhëheqës i disa delegacioneve nga Teksas në vende të tjera, por dhe drejt Kosovës në vitet 80.

Në vitin 1994 sposorizoi Ansamblin e Shtetit Shqiptar të Këngëve dhe Valleve Populllore në Amerikë dhe Kanada, me qëllim ruajtjen e promovimin e vlerave artistiko-kulturore shqiptare.

Themeluesi i Shtypshkronjës "Jalifat"

Në vitet '80 gjendja në Kosovë po përkeqësohej dhe kjo inicioi krijimin e një shtëpie botuese përbotimin e librave dhe përkthimin e veprave shqiptare, për promovimin e librave të autorëve shqiptar, si të fushës së historisë, politikës, ekonomisë dhe fushave tjera. Përkthimi i veprave me qëllim dëshminë e historisë së kombit, të prezantimit të historiografisë shqiptare, që me fakte shkencore t'i kundërvihet çdo shtrembërimi e propagande kundërshtare.

Përkthimi, botimi, shpërndarja dhe katalogimi i librave të historianit Jusuf Buxhovi (Kosova, Maqedonia), të Blerim Rekës (Gjeopolitikat në Ballkan), të Faton Bislimit (Përpjekja për lirinë shqiptare dhe fundi i Jugosllavisë), të Adem Lushajt (Krimet serbe në Kosovë-Rasti i Deçanit) dhe të tjerëve, nëpër Universitetit më të njohura amerikane, si dhe në vet kongresin amerikan.

Ramiz Tafilaj, i dhuroi Presidencës së Kosovës 100 komplete të veprës "Kosova" I,II, III në anglisht të historianit Jusuf Buxhovi. Donacioni iu dorëzua Presidencës së Kosovës, si dhe sugjeroi që një numër i konsiderueshëm i kësaj vepre t'u dhurohet ambasadave të Republikës së Kosovës që të shpërndahet.

"Kosova" I,II, III është përkthyer në anglisht dhe botuar në SHBA në vitin 2014. Si e tillë, ka depërtuar në institucionet hulumtuese shkencore dhe në universitetet më të rëndësishme amerikane, tashmë e rekomanduar si literaturë shkencore dhe në Bibliotekën e Kongresit me statusin e literaturës përhistoriografinë e Europës Juglindore. Z. Tafilaj me librat "Kosova" të Buxhovit ka udhëtuar shumë nëpër botë, vetëm me qëllim që të promovojë historinë e popullit shqiptar, duke përfshirë universitete të ndryshme nëpër botë, institucione të rëndësishme, librari e biblioteka. Vepra ka depërtuar edhe në qendra të rëndësishme universitare në Europë, Azi dhe Afrikë.

Z. Ramiz është shprehur se: "Libri dokumenton dhe mbron historinë e një kombi. Të shkruhet historia jonë pa u ndikuar nga ide apo ndjenja subjektive, që brezat pasardhës të dinë të vërtetën e vendit të tyre".

gjithë presidentët amerikanë që kanë qenë në krye të shtetit pas viteve të 70-ta, ku gjithnjë ka pasur në fokus shërbimin e tij në komunitet.

Po ashtu, Z. Tafilaj ka një kontribut të paçmueshem sa i takon mbështetjes së studentëve të huaj dhe shqiptarë drejt endrrës amerikane. Ai ka sponsorizuar mbi 100 nxënës e studentë për shkollim në Shtetet e Bashkuara qoftë për studime bazë, specializime apo doktoratura, duke iu mundësuar cdo gjë që i nevojitet një të huaji në një shtet, duke hapur dyert e shtëpisë së tij dhe përgjatë studimeve të tyre, ka pasur rolin e babait. Në një formë të pavetëdijshme ishte shndërruar në babain e mbi 100 studentëve.

Në fillim të vitit 2019 Z. Ramiz Tafilaj dekorohet me **Çmimi i Presidentit për Arritje Jetësore (President's Lifetime Achievement Award)** nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Donald Trump që është shpërblimi më i lartë që i jepet një njeriu civil jo ushtarak në Shtetet e Bashkuara me motivacion: "Keni shërbyer si model i shpirtit amerikan. Orët e shumta të shërbimit tuaj kanë forcuar lidhjet e bashkëpunimit dhe besimin që afrojn njerëzit me njëri-tjetrin, ndërsa keni ndihmuar për të zgjidhur disa nga sfidat më të mëdha të kohës sone".

Z. Tafilaj u nderua veçanërisht për punën e jashtëzakonshme për shqiptaro-amerikanët dhe për punën e tij në çështjet shqiptare në Ballkan në lidhje me politikën amerikane në rajon, por ajo që e dalloi veprimitarinë e tij të palodhshme nga të tjerët në SHBA dhe këtij çmimi i jep një peshë të veçantë, është padyshim veprimitaria e tij botuese.

Në qershor të këtij viti (09.06.2022), Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka dekoruar Z. Tafilaj me njërin nga titujt më të lartë presidencial, titullin: "Kalorësi i Urdhrit të Skënderbeut", për kontributin e madh që po jep në promovimin e vlerave kombëtare kudo në botë, e në veçanti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Motivacioni: "Në vlerësim të punës së tij humanitare, nismave, angazhimeve dhe kontributeve të tij në vendlindje dhe kudo në trojet shqiptare në Ballkan. Promovimin e vlerave kombëtare, kulturore dhe shkencore, ndihmën e pakursyer në edukimin e brezave të rinj shqiptarë në Amerikë, si dhe integrimin e tyre profesional dhe shkencor në shoqërinë amerikane. Kontributin e dhënë në demokratizimin e Shqipërisë, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; forcimin e lidhjeve historike shqiptaro-amerikane; lartësimin e imazhit të popullit shqiptar e vlerave tona kombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës".